



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

<b>DATË/A:</b>	13.08.2024
<b>REFERENC-Ë:</b>	24/3839/MMPHI
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"Zhavor Company", Sh.p.k, Podgorc, Viti Thermim dhe seperim i gurit gëlqeror, Podgorc
<b>CC:</b>	Komisioni për Leje Mjedisore
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka kontrolluar dokumentacionin për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "Zhavor Company", Sh.p.k, Podgorc, Viti, me Nr.Prot.24/3839/MMPHI, për veprimtarinë: Thermim dhe seperim i gurit gëlqeror, Podgorc.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 24/3839/MMPHI  
Datë: 13.08.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

## V E N D I M

Operatori, "Zhavor Company", Sh.p.k, Podgorc, i ndërpritet procedura administrative për veprimtarinë: Thërmim dhe seperim i gurit gëlqeror, në ngastrën, nr. 660-3, nr. 659, nr. 650-2, zona kadastrale Podgorc, Viti.



## A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore nga operatori, "Zhavor Company", Sh.p.k, Podgorc, për veprimtarinë: Thërmim dhe seperim i gurit gëlqeror, në ngastrën e nr. 660-3, nr. 659, nr. 650-2, zona kadastrale Podgorc, Viti, komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje Mjedisore ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Lejen për aktivitete të veçanta nga KPMM për seperacion;

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur të datës: 13.08.2024, konstatoi se operatori "Zhavor Company", Sh.p.k, Podgorc, për veprimtarinë: Thërmim dhe seperim i gurit gëlqeror, me nr. prot.24/3839/MMPHI, nuk i plotëson kriteret e parapara për vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, pasi qe nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë në afatin kohorë të përcaktuar në nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **mbyll procedurën administrative**, në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Viti;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.